

7.- Sipas burimit "6402", Fuat Myftia e Rasim Sina jane shprehur se A.Kondo nuk ka pranuar te flase ne radion e Legalitetit nga frika se mos u ndodh gje njerezve qe ka ketu.

Te shfrytezohet kjo me qellim qe nepermjet lidhjeve familjare qe A.Kondo ka ketu, pasi te studjohen, te shikohet mundesia e berjes se nje letre presioni prej tyre.

Kryen A.Thana brenda 6 mujorit i 1987.  
Kontrollon Kryetari i Deges VI, M.Dedaj.

8.- Te studjohen kushtet e mundesite dhe te shfrytesohet ndonje rast i pershtatshem per t'i bere edhe telefonate anonime per ta friksuar.

Kryen rezidentura ne vazhdim.  
Kontrollon Kryetari i Deges VI, M.Dedaj.

9.- Nisur nga te dhenat qe bejne fjale per shprehje te pakenacesise nga ana e A.Kondos dhe Xh.Sukniqit per [REDACTED] i cili sipas tyre nuk interesohet per pune e jetesen e keqe qe ata bejne, te shfrytezohet kjo,

a- qe agjentura jone qe ka lidhje e mundesi kontakti me keta te arratisur te punoje per t'i shtuar e thelluar keto pakenacis.

b- Mbi kete baze dhe duke shfrytezuar te dhenat e tjera mbi veset negative e pikat e dobeta qe dim per ta, te perpunohet nje leter anonime.

10.- Te ndiqen e perpunohen veprimtaria e lidhjet e tij kryesisht me Legalitetin e kreret e tij, cilet perpiqen ta mbajne me prane e ta angazhojne ne veprimtari armiqsore. Te verifikohet e sqarohet pjesemarrja e A.Kondos ne kongresin e fundit te Bllokut Independent, motivet dhe qendrimi qe ka mbajtur.

Kryen rezidentura ne vazhdim.  
Kontrollon, Kryetari i Deges VI, M.Dedaj.